



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo administracija lokalne samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 31 mars, 2026

Për: Kryetarët e komunave të Republikës së Kosovës

Lënda: Fushata për regjistrimin falas për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

Të nderuar Kryetarë/e,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), konform mandatit ligjor të përcaktuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren (QNR) Nr. 04/2026 për fushat dhe përgjegjësisë administrative të ministrive, me qëllim të mbështetjes së komunave në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe përmbushjen efikase të nevojave dhe kërkesave të qytetarëve, përmes kësaj shkrese adreson çështjen e regjistrimit falas të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ju rikujton se muaji **prill** duhet të shpallet muaj i regjistrimit falas për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, duke krijuar lehtësira dhe duke ofruar informacione të plota dhe të nevojshme për regjistrimin e tyre.

Regjistrimi falas ka për qëllim promovimin e të drejtave themelore të këtyre komuniteteve, në veçanti të drejtës për regjistrim, si një nga elementet më të rëndësishme për përfshirjen e tyre në shoqërinë kosovare.

Komunat në të cilat jetojnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, pas përfundimit të fushatës, obligohen të raportojnë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për ecurinë e saj, përfshirë numrin e personave nga radhët e këtyre komuniteteve që kanë aplikuar dhe numrin e atyre që janë regjistruar.

Raportimi duhet të bëhet tek znj. **Luljeta Ibishi Ferizi**, Zyrtare e Lartë për të Drejtat e Njeriut në komuna/MAPL, në adresën elektronike: luljeta.ibishi@rks-gov.net.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është e përkushtuar të ofrojë mbështetje dhe ndihmë të plotë në zbatimin e obligimeve të komunave që dalin nga legjislacioni për vetëqeverisje lokale.

Me respekt,

Elbert Krasniqi



Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal

Kopje:

- z. Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
- z. Lendrit Iljazi, Udhëheqës i DDLBNK – së
- z. Luljeta Ibishi Ferizi, Zyrtare e Lartë për të Drejtat e Njeriut në komuna.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo administracija lokalne samouprave
Ministry of Local Government Administration

Priština, 31. mart 2026.

Za: Gradonačelnici opština Republike Kosovo

Predmet: Kampanja za besplatnu registraciju za zajednice Roma, Aškalije i Egipćana

Poštovani gradonačelnici,

Poštovane gradonačelnice,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS), u skladu sa zakonskim ovlašćenjima utvrđenim Zakonom br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi i Uredbom (VRK) br. 04/2026 o administrativnim oblastima i odgovornostima ministarstava, sa ciljem podrške opštinama u vršenju ovlašćenja utvrđenih sa zakonodavstvom na snazi i efikasnom zadovoljavanju potreba i zahteva građana, ovim pismom upućuje pitanje besplatne registracije zajednica Roma, Aškalija i Egipćana.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS), podseća vas da mesec april treba proglasiti mesecom besplatne registracije za Romske, Aškalijske i Egipćanske zajednice, stvarajući uslove i pružajući potpune i neophodne informacije za njihovu registraciju. Besplatna registracija ima za cilj promociju osnovnih prava ovih zajednica, posebno prava na registraciju, kao jednog od najvažnijih elemenata za njihovo uključivanje u kosovsko društvo.


Opštine u kojima žive zajednice Roma, Aškalija i Egipćana, nakon završetka kampanje, dužne su da izveštavaju Ministarstvo administracije lokalne samouprave o njenom napretku, uključujući broj ljudi iz ovih zajednica koji su se prijavili i broj onih koji su se registrovali.

Izveštavanja se dostavljaju kod gđe. **Luljeta Ibishi Ferizi**, viša službenica za ljudska prava u opštinama /MALS, na elektronskoj adresi: luljeta.ibishi@rks-gov.net.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave posvećeno je pružanju pune podrške i pomoći u sprovođenju obaveza opština koje proizilaze iz zakonodavstva o lokalnoj samoupravi.

S poštovanjem,

Elbert Krasniqi



Ministar administracije lokalne samouprave

Kopija:

g. Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a,

g. Lendrit Iljazi, rukovodilac Odeljenja za lokalnu demokratiju i međuopštinsku saradnju (OLDMOS)

g. Luljeta Ibishi Ferizi, viša službenica za ljudska prava u opštinama.